

KOSOVA, VEND I TOLERANCËS DHE BASHKËPUNIMIT



E DREJTA E INFORMIMIT NË DEMOKRACI

SAMIR (13), KUJTIM (15), AGNESA (13), DIELLON (13), AID (13), ALBIONA (13), ANDI V. (13), NART (14)



Nëse doni të dini më shumë për mjetet informuese dhe rëndësinë e tyre në demokraci, lexoni artikullin tonë më poshtë

Po e fillojmë këtë artikull me një thënie me peshë shumë të madhe, e cila thotë: „Arma më e fuqishme është dija.“ Ne e mbështesim plotësisht këtë thënie, sepse njeriu që është i ditur mund të tejkaloj çdo pengesë dhe ta përmbys pothuajse çdo sfidë në jetë.

Dijen ne mund ta fitojmë çdo ditë, për shembull duke lexuar libra të ndryshëm. Libri konsiderohet si miku më i mirë i njeriut. Por, përveç librit, ne marrim dije edhe nga gazetatat, revistat, televizioni, radio, telefoni, romanet, etj. Të gjitha këto që i përmendëm, ne mund t'i përmbledhim me një emër të vetëm të quajtur media.

Ne sot jemi këtu në rolin e gazetarëve dhe ne do ta tregojmë rëndësinë e medias. Për shembull, për Ditën e Pavarësisë së Kosovës, pra më 17 shkurt, e që është një datë shumë e rëndësishme për të gjithë ne, media na ka informuar disa ditë më parë për agjendën e manifestimit të kësaj feste madhështore. Festimet e Pavarësisë së Kosovës, këtë vit filluan që nga data 16 shkurt, duke e zvogëluar kështu orarin e mësimin në shkollat tona. Të nesërmen, u organizua një koncert super i madh. Në mbrëmje performoi këngëtarja e njohur me famë botërore dhe njëkohësisht ambasadorja e Kosovës Rita Ora. Më 18 shkurt festimet vazhduan me performimin e paradës së FSK-së, në qendër të

Prishtinës.

Shembull tjetër se si media na ndihmon neve është përmes kumtimit të rezultateve të zgjedhjeve shtetërore. Përmes tyre ne e kuptojmë se cila parti ka dalur e para për nga votat e qytetarëve.

Ne dëshirojmë të bëjmë një ndërlidhje të medias dhe demokracisë. Sikurse çdo individ, i cili ka të drejtë ta zgjedhë profesionin e tij sipas dëshirës, edhe ata që kanë zgjedhur të jenë gazetarë, kanë të drejtë dhe detyrë t'i informojnë qytetarët lirshëm. Në demokraci ekziston edhe liria e medias dhe e informimit.

Ne dëshirojmë t'iu japim një mesazh të gjithë qytetarëve të cilët e lexojnë këtë artikull, se media është e rëndësishme për të gjithë ne. Ajo na ndihmon duke na informuar për ndodhitë e reja, si brenda ashtu edhe jashtë shtetit tonë.



Ne zgjedhëm që sot të jemi gazetarë


RËNDËSIA E KUVENDIT NË JETËN TONË

VALMIR (14), FLORIAN (14), VALMIRA (15), ERËZA (13), SUELA (13), ENIT (15), MENSUR (14),
ERON (13), OLTİ (13)



Si ndikon Kuvendi në jetën dhe në të ardhmen tonë? Këto informata do t'i mësoni në artikullin në vijim

Kuvendi është shtylla e vendit tonë, që përbëhet nga 120 deputetë, të cilët e përfaqësojnë popullin në mënyrë të përgjegjshme dhe të drejtë. Pa punën e përgjegjshme të tyre, jeta jonë nuk do të ishte aq e mirë, për arsye se do të kishte mundësi të shkeleshin të drejtat e njeriut. E kjo nënkupton se do të kishte më pak miratim të ligjeve që janë mjaft efektive për popullin.



Duke zgjedhur deputetët e duhur për ta përfaqësuar shtetin tonë

Kuvendi ndër të tjerash ka tri funksione kyçe: funksionin legjislativ, që nënkupton propozimin dhe miratimin e ligjeve; funksionin përfaqësues, që nënkupton përfaqësimin e popullit; si dhe funksionin kontrolues, që nënkupton kontrollimin e institucionit që i vë në zbatim ligjet, e që është Qeveria. Nga vendimet që merren në Kuvend ndikohet jeta jonë në të gjitha

sferat. Këtë e themi duke u nisur nga disa ligje që na e mbrojnë neve nga çdo lloj diskriminimi.


E një nga ligjet që merret me këtë çështje është pikërisht ligji kundër diskriminimit, i miratuar në vitin 2004. Ky ligj ka të bëjë me parimin e mirëkuptimit dhe tolerancës ndër-etnike, trajtimin e barabartë dhe përfaqësimin e drejtë të të gjithë personave të komuniteteve lidhur me punësimin në kuadër të organeve publike në të gjitha nivelet. Pra, natyra e trajtimit të barabartë fillon në Kuvend, ku në mesin e 120 deputetëve, 20 janë të komuniteteve të tjera jo shumicë. Kjo e dëshmon frymën demokratike që mbizotëron në institucionin tonë ligjvënës. Këtë natyrë të funksionimit e kemi edhe ne në shkollën tonë, ku tregojmë respekt të veçantë ndaj komuniteteve jo shumicë. Ne marrim model nga Kuvendi dhe bëhemi vetë shembull i qytetarëve, të cilët jetojnë me parime demokratike.




Kolegët gazetarë



Qëllimet e përbashkëta arrihen atëherë kur ulemi në tryezë të rrumbullakët dhe i diskutojmë gjërat shtruar secili sipas perspektivës së tij. Kjo nënkupton lirinë e shprehjes, respektimin e mendimit të tjetrit dhe vullnetin për të bashkëpunuar




Shteti i Kosovës i jep mundësi secilit që të kontribuoj sipas mundësisë së vet. Kjo e fuqizon rolin e qytetarëve



Në demokraci udhëheqja është e përbashkët. Kjo i bie se të gjithë kemi të drejtë të zgjedhim dhe të jemi të zgjedhur



Media, burim i informacioneve të ndryshme që ndodhin brenda dhe jashtë vendit




Gjithçka që bëjmë ne për demokracinë, duam ta mbajmë dëshmi

TË MENDOJMË PARA SE TË ZGJEDHIM

ELVIN (13), ANDI (14), RREZON (13), BLENDINA (13), RAMADIJE (14), ENDRIT (13), RINA (13),


LORIK (13)



Disa fakte rreth zgjedhjeve

E drejta e zgjedhjes së lirë është një ndër të drejtat kryesore që qytetarët duhet ta gëzojnë. Themi duhet, sepse ende në botë ka vende që qytetarët nuk e jetësojnë këtë të drejtë. Janë ato vende të cilat si sistem të qeverisjes nuk e kanë demokracinë.

Ne, si nxënës pa dyshim që nuk ndihemi mirë kur dëgjojmë këto raste. Mirëpo, në anën tjetër, ndihemi jashtëzakonisht të lumtur kur e dijmë që në vendin tonë të gjithë qytetarët pa dallime race, feje, gjinie, e gëzojnë këtë të drejtë.



Një preferencë e jonë

Ajo çka ne presim nga ju të dashur lexues është të keni vullnet dhe dëshirë që ta përfundoni së lexuari artikullin tonë. E pastaj ta gjykoni se a ishte mjaftueshëm informues dhe përfitues për ju, ashtu siç ishte për ne

Në fund të gjysmëvjetorit të parë të këtij viti, ne nxënësit e shkollës „Selman Riza“ iu nënshtruan disa teste nga lëndë të ndryshme. Pyetjet nuk ishin shumë të lehta dhe kërkonin shumë mund dhe angazhim për t'u përgjigjur saktë. Kjo sepse për secilën pyetje ekzistonin nga katër opsione, e që të gjitha ishin shumë të përafërta me njëra-tjetrën. Pa dyshim që nxënësit të cilët ishin përgatitur e kishin më të lehtë. Ndërsa, për disa të tjerë ishte paksa më e vështirë. Por, në fund të gjithë arritëm rezultate të mira, pas angazhimit tonë maksimal gjatë testeve.

Arsyeja pse e filluam artikullin në këtë mënyrë është sepse ne sot në grup të vogël pas diskutimit të gjerë rreth zgjedhjeve, edukatorja na kërkoi që të lidhim zgjedhjet me ndonjë zgjedhje të rëndësishme që ne kishim bërë kohëve të fundit. Shembulli ynë nuk mund të themi që është i njëjtë me ato çka ne diskutuam në grup, por rëndësia e tij është mjaftueshëm e madhe. Në rastin tonë, ne bëmë zgjedhjen e opsionit të përgjigjes që menduam se i përshtatet më së shumti pyetjes që ishte e parashtruar. Po të mos kishim treguar kujdes gjatë leximit të opsioneve, nuk besojmë që do të kishim treguar të njëjtin rezultat. Kjo ishte një ndër zgjedhjet më të rëndësishme kohëve të fundit. Po i referohemi si zgjedhje, pasi që testi ishte me opsione

dhe nga ne kërkohet që të zgjedhim vetëm njërin nga ato opsione si të saktë. Kështu ndodh edhe me zgjedhjet shtetërore. Qytetarët mbi moshën 18 vjeçare para se të vendosin se për kë të votojnë mendohen mirë e pastaj e japin votën e tyre. Rëndësia e kësaj vote është shumë e madhe.

Në vendin tonë, qytetarët marrin pjesë në dy lloje të zgjedhjeve: në ato qendrore dhe lokale. Në zgjedhjet qendrore votohen deputetët, ndërsa në zgjedhjet lokale votohen kryetari i komunës dhe asamblistët. Të dyja këto zgjedhje kërkojnë kujdes dhe vigjilencë, ashtu siç kërkonin kujdes testet tona. Dallimi i tyre është se kur marrim pjesë në zgjedhjet shtetërore ndikimi i tyre është përtej personales, kurse në rastin tonë të zgjedhjes është çështje personale.



Përfaqësuesit e shkollës „Selman Riza“



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Selman Riza“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-5
Website: www.demos-ti.org Vendi: Fushë Kosovë